



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 7774 Prot.

Tiranë, më 27.3 /2019

UDHËZIM

NR. 06, DATË 27.3 2019

“MBI ZBATIMIN E PROCEDURAVE TË MIRATIMIT DHE PËRDORIMIT TË
DEKLARIMIT TË THJESHTËZUAR”

Nisur nga kerkesat, gjithnjë në rritje, në drejtim të thjeshtesimit te procedurave dhe krijimin e lehtësive doganore për operatorët ekonomike ;

Më qëllim krijimin e kushteve për favorizim dhe nxitje të tregëtisë, uljen e kohës dhe kostos së procedurave doganore;

Bazuar në Ligjin 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë;

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave;

UDHËZON:

1. QËLLIMI

Me anë të këtij Udhëzimi përcaktohen kushtet dhe kriteret që duhen plotësuar për aplikimin dhe shfrytëzimin e procedurës së Deklarimit të Thjeshtëzuar (DTH)

2. PËRKUFIZIME

Përkufizimet ose rregullat e interpretimit që i përmban Ligji 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar, si dhe Vendim i Këshillit të Ministrave nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, vlejné gjithashtu edhe për këtë Udhëzim

3. KUSHTET PER PËRDORIMIN E PROCEDURËS SË DEKLARIMIT TË THJESHTËZUAR

Në varësi nga kushtet e paraqitura më poshtë, një deklaruesi i lejohet të dorëzojë një deklaratë për vendosjen e mallrave të importuara në qarkullim të lirë ose eksport të mallrave në një mënyrë më të thjeshtësuar nëpërmjet Dokumentit Administrativ të Vetëm (DAV) përkatës, për një operator ekonomik, në rast se:

- 3.1 Është bërë një kërkesë për përdorimin e procedurës së deklarimit të thjeshtëzuar;
- 3.2 Përdorimi i procedurës së deklarimit të thjeshtëzuar është autorizuar nga Autoritetet Doganore Shqiptare;
- 3.3 Deklaruesi/importuesi nuk është person i cili ka kryer ndonjë shkelje serioze ose shkelje të përsëritura të rregullave doganore (gjate dy viteve të kaluara);
- 3.4 Deklaruesi/importuesi deklaron mallrat për vendosje në qarkullim të lirë rregullisht;
- 3.5. Nuk rezulton si mbajtës ndonjë nga regjimet doganore ekonomike, që lejohen me dispozitat doganore në fuqi, me përjashtim të rasteve specifike, kur kemi të bëjmë me mallra lehtësisht të identifikueshme dhe operatori ekonomik përdor vetëm regjimin e përpunimit aktiv (IM5), ndërsa çdo regjim tjetër përjashtohet;
- 3.6. Është tatimpagues i rregullt dhe mos të ketë detyrime tatimore të pashlyera pranë autoriteteve tatimore të Republikës së Shqipërisë;
- 3.7 Të ketë sistem të arkivimit (manual dhe elektronik) të dokumenteve për mallrat e importuar me procedurë të thjeshtëzuar.

4. MALLRAT QË AUTORIZOHEN PËR PËRDORIMIN E PROCEDURËS SË DEKLARIMIT TË THJESHTËZUAR

1. Procedura e deklarimit të thjeshtëzuar mund të autorizohet për ngarkesa të mallrave që kanë kod tarifor të Nomenklaturës së Kombinar (NK) të njëjtë, karakteristika teknike dhe emërtim tregtar të llojit të njëjtë, që janë lehtësisht të identifikueshme dhe për te cilat nuk ka nevojë të kërkohen dokumente shtesë si për klasifikim sipas NK ashtu edhe për përcaktimin e origjinës, si dhe pranimin e vlerës së paraqitur në faturë duke plotësuar edhe kushtet tjera si në vijim:

- 1.1 nëse mallrat importohen në dërgesa që përbëhen vetëm nga një artikull (nje lloj malli për një dërgesë). Megjithatë, një autorizim mund të jepet për të mbuluar disa lloje mallrash, si dhe mund të jepet për më tepër se një autorizim (p.sh. një autorizim për një degë doganore) për të njëjtin deklarues;

- 1.2 nëse mallrat paraqesin një rrezik të ulët në lidhje me detyrimet doganore;
 - 1.3 nëse mallrat nuk i nënshtrohen detyrimit të akcizës;
 - 1.4 nëse mallrat nuk u nënshtrohen masave të politikës tregtare;
 - 1.5 nëse mallrat janë të paketuara në pako standarte dhe që numërohen lehtë;
 - 1.6 nëse mallrat transportohen në atë formë që mund të kontrollohen lehtë pa u shkarkuar;
 - 1.7 nëse vlera e mallit për një ngarkesë që nuk është më e madhe se 6000.00 €, duke përjashtuar rastet specifike sipas natyrës së mallit.
2. Të gjitha mallrat që mund të autorizohen për përdorimin e procedurës së Deklarimit të Thjeshtëzuar janë të listuara në Aneksin III.
- 2.1 Lista e mallrave në Aneksin III, mund të ndryshojë bazuar në kërkesat e arsyetuara nga Degët Doganore dhe me aprovimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

5. KUSHTET PËR MIRATIMIN E AUTORIZIMIT PËR PËRDORIMIN E PROCEDURËS SË DEKLARIMIT TË THJESHTËZUAR

1. Me rastin e aplikimit, personi parashtrues i kërkesës për autorizim, duhet t'i prezantojë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave argumentimin ekonomik lidhur me nevojën për përdorimin e procedurës së deklarimit të thjeshtëzuar (si psh: vëllimin e importit/eksportit, kostot, etj), ta mbështesë kërkesën me fakte që lidhen me mallrat e kontraktuar apo me kompanitë transportuese si dhe plotësimin e kushteve të tjera si në vijim:

- 1.1. Prezantimi i vëllimit të import/eksportit dhe konfirmimi nëse deklarohen produkte rregullisht apo vetëm brenda një sezoni. Për të siguruar një aplikim të drejtë dhe të paanshëm të kushteve dhe kritereve siç janë paraqitur më lartë, autoriteti i autorizuar doganor (Sektori i Lehtësive Doganore, Tranzitit dhe Informimit të Operatorëve) duhet të ketë parasysh karakteristikat specifike të aplikantit, duke përfshirë madhësinë dhe volumin e tij operacional.
- 1.2. Përdoruesi i procedurës së Deklarimit të Thjeshtëzuar duhet të autorizojë personin/at përgjegjës;
- 1.3. Të sigurojë që fatura e cila deklarohet nëpërmjet procedurës së Deklarimit të Thjeshtëzuar të përmbajë të gjitha elementet e përshtatshme dhe të nevojshme për zhdoganim;

- 1.4. Të ketë mundësi për paraqitje të deklaratës në formën e përcaktuar (deklarates jo te plote), si dhe atë përmbledhëse në forme elektronike në sistemin Asycuda World;
- 1.5. Të mbajë evidencë për dërgesat e çliruara nën procedurën Deklarimit të Thjeshtëzuar;
- 1.6. T'i mundesojë autoriteteve doganore akses në kontrollet fizike të mallit, si dhe akses fizik e elektronik për dokumentacionin që shoqëron Deklarimin e Thjeshtuar,
- 1.7. Për qëllime të miratimit të autorizimit për përdorimin e Deklarimit të Thjeshtëzuar, paraprakisht të konstatohet nëpërmjet një konfirmimi me shkrim, me të cilin dëshmohet se Dega Doganore kompetente ka kapacitetet e mjaftueshme për mbikëqyrje dhe kontroll të çdo procedure të Deklarimit të Thjeshtëzuar të autorizuar.
- 1.8. Të mos jetë i proceduar penalisht për vepra penale që lidhen me aktivitetin ekonomik të aplikuesit si dhe të mos jetë subjekt i procedurave të falimentimit;
- 1.9. Në Deklaratë të Thjeshtëzuar nuk mund të përfshihen mallrat për të cilat nevojitet miratimi paraprak nga organe ose agjensi të tjera inspektimi (mallrat për të cilat kerkohet të licenca ose autorizime paraprake nga Institucione të tjera).
- 1.10. Mallrat për të cilat kerkohet licenca/ autorizime por që janë të përfshira në Aneksin III të këtij Udhëzimi, përjashtohen nga kushtet e përcaktuara në paragrafin 1.9.

6. KËRKESA PËR PAISJE ME AUTORIZIM

1. Kërkesa për autorizim (sipas aneksit II) duhet të paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave e cila verifikon nëse ajo dhe dokumentacioni bashkëngjitur janë në përputhje me kushtet e përcaktuara.
2. Në rast konstatimi të mangësive në dokumentacionin bashkëngjitur të kërkesës, operatorit ekonomik i kërket plotësimi i rregullt i këtij dokumentacioni.
3. Kërkesa për autorizim për Deklarim të Thjeshtëzuar trajtohet nga Sektori i Lehtësive Doganore, Tranzitit dhe Informimit të Operatorëve pranë Drejtorisë së Procedurave Doganore në Departamentin Teknik të Akcizës dhe Procedurave Doganore.
4. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, brenda një afati prej 30 ditësh kalendarike, nga data e paraqitjes së kërkesës, del me vendim përkatës për miratim ose refuzim të dhënies të autorizimit për Deklarim të Thjeshtëzuar..

7. AUTORIZIMI

1. Në rast miratimi të kërkesës subjekti autorizohet (sipas formës së paraqitur në Aneksin I), duke specifikuar detajet për llojin e mallit, origjinën, kodin tarifor, kohëzgjatjen e autorizimit, si dhe përgjegjësitë e mbajtësit apo deklaruesit si për deklarimin e mallit nëpërmjet deklaratës jo të plotë në hyrje po ashtu edhe për deklarimin për zhdoganimin përfundimtar.

2. Në autorizim pasqyrohet saktë kodi i zyrës doganore ose nëse kemi më shumë se dy zyra doganore, kodet respective të zyrave doganore të autorizuara në hyrje dhe shkarkimit të kësaj procedure.

3. Autorizimi lëshohet me kushtin që zyra doganore të mundësojë procedurat e deklarimit të thjeshtëzuar vetëm pasi operatori ekonomik të ketë plotësuar llogarinë parapaguese, në Sistemin Asycuda World, me një shumë jo më të vogël se shuma e parashikuar e detyrimeve doganore për mallrat në fjalë.

8. DEKLARATA E THJESHTËZUAR

1. Një deklaratë e thjeshtëzuar për hedhje në qarkullim të lirë ose eksport të mallit, mund të bëhet me anë të deklarimit jo të plotë, duke prezantuar:

1.1 kopje të faturës;

1.2 certifikatën e origjinës së mallit;

1.3 dokumente të tjera të detyrueshme për zbatimin e dispozitave që rregullojnë vendosjen në qarkullim të lirë të mallrave të deklaruara.

1.4 në rubrikën përkatëse të deklaratës jo të plotë duhet të shënohet vlera dhe numri i faturës që shoqëron mallin.

1.5 në rastin e importit, në rubrikën përkatëse të deklaratës jo të plotë, duhet të shënohet shuma e cila mbulon borxhin doganor. (shuma e depozituar në llogarinë parapaguese)

2. Deklarata e thjeshtëzuar depozitohet në sistemin Asycuda World nga operatori ekonomik ose përfaqesuesi i tij (agjenti doganor) i autorizuar, para importit/eksportit.

3. Pas mbërritjes së mallrave në zyrën doganore, autoritetet doganore duhet të vërtetojnë se;

3.1 subjekti është autorizuar për procedurë të Deklarimit të Thjeshtëzuar.;

3.2 malli i deklaruar përputhet me kushtet e specifikuar në Autorizim;

3.3 detyrimet e importit janë depozituar në llogarinë parapaguese

4. Nëse malli i deklaruar është në përputhje me kushtete autorizimit, konfirmohet në sistem mbërritja e mallit, dhe më pas autoritet doganore në bazë të kriterëve të riskut, njoftojnë operatorin ekonomik ose përfaqësuesin e tij, se:

4.1 mallrat duhet t'u nenshtrohet procedurave të rregullta të kontrollit (kanali i kuq) duke e drejtuar në terminalin më të afërt doganor.

4.2 mallrat që nuk trajtohen sipas paragrafit 4.1 nuk mund te trajtohen nga operatori ekonomik për deri dy orë pas mbërritjes në vendin e destinacionit

5. Mosrespektimi i kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në autorizim, konsiderohen shkelje të dispozitave ligjore.

9. ANALIZA E RISKUT

1. Të gjitha dërgesat me procedurë të thjeshtëzuar, duhet t' i nenshtrohen sistemit të analizës së riskut

2. Zyra Doganore kompetente, bazuar në informacionin paraprak, njofton Operatorin Ekonomik se ngarkesa për arsye sigurie dhe kontrolli, duhet te për kryerjen e Deklaratës së Thjeshtëzuar në terminalin më të afërt doganor.

3. Ushtrohet kontroll fizik vetëm ndaj dërgesave të selektuara nga analiza e riskut (qendror apo lokal).

4. Autoritet doganore brenda 60 minutave të qëndrimit të ngarkesave në hapësirat e terminalit doganor, njoftojnë Operatorin Ekonomik për ngarkesat e perzgjedhura për kontroll fizik.

5. Përjashtim nga paragrafi 4, bëjnë ngarkesat të cilat arrijnë në terminalin doganor pas përfundimit të orarit zyrtar të punës. Në këto raste, njoftimi për kontroll fizik kryhet brenda 60 minutave të ditës së nesërme të orarit zyrtar..

10. DEKLARATA E PËRGJITHSHME PËR HEDHJE NË QARKULLIM TË LIRË:

1. Mallrat e importuara nën kushtet e autorizimit për Deklarim të Thjeshtëzuar, duhet të deklarohen për zhdoganim definitiv jo më vonë se ditën e parë të punës pas paraqitjes së mallrave në Doganë.

2. Deklarata përmbledhese duhet të dorëzohet në zyrën përkatëse të Doganës.

3. Deklaratat e përgjithshme në formularin IM 4, depozitohet në sistemin Asycuda World në përputhje me dispozitat përkatëse për këtë qëllim

4. Zyra doganore e autorizuar bën krahasimin e të dhënave të deklaratës së përgjithshme me kopjet e deklaratave jo të plota dhe faturave të bashkangjitura me të dhënat në sistemin elektronik Asycuda World.

11. PEZULLIMI I AUTORIZIMIT

1. Autorizimi për procedurën e thjeshtëzuar pezullohet nga organi kompetent:

1.1 në rast evidentimi mospërputhjeje me kriteret dhe kushtet e percaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij Udhëzimi;

1.2 në rast se mbajtësi i autorizimit ka kryer një veper penale që ndërlidhet me shkelje të rregullave doganore, tatimore dhe ligje të tjera të cilat zbaton Administrata Doganore;

1.3 me kërkesë të mbajtësit të autorizimit, i cilideklarohet përkohësisht i paaftë për të përmbushur kriteret dhe kushtet për autorizimin për Deklarim të Thjeshtëzuar.

2. Në rastin e përmendur ne paragrafin 1.1, zyra doganore kompetente i komunikon parregullsinë e konstatuar mbajtësit të autorizimit, i cili detyrohet të rregullojë situatën jo më vonë se brenda 30 ditëve kalendarike nga data e komunikimit. Nëse nuk korigjohen parregullsitë brenda afatit të përcaktuar, zyra kompetente pezullon autorizimin. Kur mbajtësi i autorizimit ka ndërmarrë masat e nevojshme në përputhje me kushtet dhe kriteret e autorizimit, zyra kompetente revokon pezullimin.

3. Në rastet e përmendura në pikën 11.1.2, zyra kompetente pezullon autorizimin deri në përfundim të procesit penal.

12. REVOKIMI DHE NDRYSHIMI I AUTORIZIMIT

1. Pa rënë ndesh me dispozitat e këtij Udhëzimi, autoritetet doganore kanë të drejtë të revokojnë autorizimin për procedurën e deklarimit të thjeshtëzuar në rastet e mëposhtme:

1.1. në rast se ndonjeri nga kushtet e detyrueshme të parashikuara në pikat 3,4 dhe 5 të këtij udhëzimi nuk vazhdojnë të zbatohen;

1.2 në rast se mbajtësi i autorizimit nuk ka rregulluar situatën në lidhje me rastet e pezullimit, siç përmendet në pikën 11 të këtij udhëzimi. ;

1.3 në rast se mbajtësi i autorizimit ka kryer shkelje serioze dhe të përsëritura të legjislacionit doganor dhe tatimor

1.4 me kërkesëtë mbajtësit të autorizimit;

1.5 për mosshfrytëzim të përfitimeve nga autorizimi për një periudhë mbi 6 muaj.

2. Autorizimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, modifikohen nëse një faktor/element i shtuar më pas mund të ndikojnë në përmbajtjen e elementëve mbi të cilët është lëshuar autorizimi.

13. DETYRIMET E DEKLARUESIT

1. Subjekti i autorizuar për procedurat e thjeshtëzuara duhet të përmbushë detyrimet dhe kushtet e përcaktuara në dispozitat e këtij Udhëzimi në lidhje me regjimet specifike të autorizuar, si dhe duhet të përmbushë kërkesat dhe specifikimet përkatëse që përmbahen në autorizimet e lëshuara.

14. VENDI I MBËRRITJES/NISJES

1. Mallrat që i nënshtrohen procedurave me deklaram të thjeshtëzuar mund të kryejnë procedurat doganore në hapësirat dhe në vendet e përcaktuara në Autorizim.

2. Çdo ndryshim i vendit të kryerjes së procedurës së thjeshtëzuar I ndryshëm nga ai I përcaktuar në autorizim bëhet nëpërmjet një dispozite të vecantë shtesë në autorizimin e lëshuar më parë.

15. VERIFIKIMI DHE KONTROLLET TEKNIKE

1. Zyra Doganore mbikqyrëse e përcaktuar në autorizim kryen në vazhdimësi mbikqyrjen e respektimit të kushteve të autorizimit nga ana e operatorit ekonomik.

2. Strukturat e mbikqyrjes së regjimeve apo ato të kontrollit pas zhdoganimit në zyrën doganore mbikqyrëse duhet të kryejnë kontrolle të paktën një herë në vit, me qëllim monitorimin e autorizimeve të lëshuara.

16. HYRJA NE FUQI

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë

Belinda IKONOMI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM



**KËRKESË PËR MIRATIM TË AUTORIZIMIT PËR PËRDORIMIN PROCEDURËS
SË DEKLARIMIT TË THJESHTËZUAR**

1. Kërkuesi (Personi të cilit i lëshohet Autorizimi)

Emri dhe Mbiemri i paraqitësit të kërkesës
Emri dhe Adresa e Subjektit
Nr.NIPT
Nr. Kontakti

2. Të dhënat e personit/ave përgjegjës apo të autorizuar

Emri Mbiemri
Telefon
Adrese email
Kodi i Agjentit Doganor

3. Artikuj

Nr.	Emërtimi tregtar i mallit	Kodi tarifor	Procedura Doganore	Kodi I Procedures Doganore	Origjina e Mallit	Mënyra e paketimit

4. Menyra e mbajtjes së evidencës dhe arkivimit të dokumentacionit

5. Lloji i Transportit

6. Zyra doganore mbikëqyrse

7. Afati për paraqitjen e DAV

8. Dokumentacioni bashkëngjitur

9. Afati kohor për shfrytëzimin e Deklarimit të Thjeshtëzuar.

10. Me paraqitjen e kërkesës pranoj që ti mundësojmë Autoriteve Doganore akses në të gjitha dokumentat dhe evidencat me qëllim kontrollin e mallit dhe procedurave .

11. Informacion shtesë ne lidhje me justifikimin ekonomik të përdorimit të kësaj procedure.

11. Vendi Data

Emri, Firma, vula

AUTORIZIM PËR PËRDORIMIN PROCEDURËS SË DEKLARIMIT TË THJESHTËZUAR

Nr. ___ prot., datë _____ 20__

I referohet kërkesës Nr. ___ prot., datë _____ 20__

1. Mbajtësi i Autorizimit

Emri dhe Adresa e Subjektit

Nr.NIPT

Kontakti (Tel/Mail)

2. Të dhënat e personit/ave përgjegjës apo të autorizuar

Emri Mbiemri

Telefon

Adrese email

Kodi i Agjentit Doganor

3. Artikuj

Nr.	Emërtimi tregtar i mallit	Kodi tarifor	Procedura Doganore	Kodi I Procedures Doganore	Origjina e Mallit	Mënyra e paketimit

4. Masat Identifikuese/ Dispozitat e vecanta**5. Zyra doganore mbikëqyrse**

6. Afati për paraqitjen e DAV

7. Dokumentacioni bashkëngjitur

8. Afati kohor për shfrytëzimin e Deklarimit të Thjeshtëzuar.

10. Shënime me rëndësi:

Mbajtësi i Autorizimit duhet të informoj Autoritetet Doganore për çfarëdo lloj faktorësh/ elementësh që rrjedhin apo të dhëna të ndryshuara pas marrjes së autorizimit, të cilat mund të ndikojnë në vazhdimësinë apo përmbajtjen e tij.

11. Vendi Data

Emri, Firma, vula

**LISTA E MALLRAVE TE LEJUARA NE PROCEDURE TE
THJESHTËZUAR**

KODI	PERSHKRIMI
0102	Gjedhë të gjalla:
0102 21	--Të racës së pastër për riprodhim
0105	Shpendë të gjallë, domethënë, shpendët e llojit Gallus domesticus, rosa, pata, gjela deti dhe shpendë indie
2505	Rërë natyrale e të gjitha llojeve, nëse është apo jo e ngjyrosur, përveç: rërës metal-duruese të Kapitullit 26:
2505 90 00	- Të tjera
2517	Guralecët, zhavorri, gurët e thyer apo të shtypur, të një lloji të përdorur kryesisht për betonim, për metalizimin e rrugëve apo për hekurudhat apo balaste të tjera, petaver dhe strall, nëse janë apo jo të trajtuara me nxehtësi; zhavorr për të shtruar rrugët prej zgjyre, bramce apo prej mbeturinave të ngjashme industriale, nëse janë apo jo të bashkuar me materialet e dhëna në pjesën e parë të kreut; zhavorr i lyer me katran për të shtruar rrugët; copat, pluhuri dhe granulat e gurëve të kreut Nr. 2515 apo 2516, nëse janë apo jo të trajtuara me nxehtësi:
2517 10 20	-- Gur gëlqeror, dolomitë dhe gurëra të tjerë gëlqerorë, të thyer apo të shtypur
2517 10 80	-- Të tjera
2517 30 00	Zhavorr i lyer me katran për të shtruar rrugët
2523	Çimento portland, çimento oksidalumini, çimento skoriesh, çimento super sulfati dhe çimento të ngjashme hidraulike, nëse janë apo jo të ngjyrosur apo në formën e klinkerit:
2523 21 00	-- Çimento e bardhë, nëse është apo jo e ngjyrosur artificialisht
2523 29 00	-- Të tjera

Aneksi III

2601	Xeherore dhe koncentrate hekuri, përfshirë piritin e pjekur të hekurit:
2601 11 00	Xeherore dhe koncentrate hekuri, përveç piritit të pjekur të hekurit: -- I pa aglomeruar
2608 00 00	Xeherore dhe koncentrate zinku
2610 00 00	Xeherore dhe koncentrate kromi
2619 00	Skorie, zgjyra (përveç zgjyrave të granuluara), shtresë e oksidit të hekurit që shfaqet gjatë farkëtimit dhe mbetje të tjera nga përpunimi i hekurit dhe çelikut:
2619 00 90	- Të tjera
2701	Qymyr; briketa, forma vezake dhe lëndë djegëse të ngjashme të forta të prodhuar prej qymyrit
	- Qymyr, nëse është apo jo i grimtuar, por jo i aglomeruar:
2702	Linjit, nëse është apo jo i aglomeruar, duke përjashtuar qelibarin e zi
2702 10 00	- Linjit, nëse është apo jo i grimtuar, por jo i aglomeruar (ECSC)
2704 00	Koks dhe gjysëm koks prej qymyrit, linjtit apo prej torfe, nëse është apo jo i aglomeruar; karbon i konvertuar :
2704 00 10	- Koks dhe gjysëm koks prej qymyrit
2704 00 30	- Koks dhe gjysëm koks prej linjtit
2713	Koks naftë, bitum naftë dhe mbetje të tjera të vajrave të naftës apo të vajrave të fituar prej mineraleve bituminoze:
2713 11 00	- Koks naftë: --E pa kalciuuar
2713 20 00	- Bitum naftë
2715 00 00	Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyral, në bitumin natyral, në bitumin e naftës, në katranin mineral apo në terpentinën e katranit mineral (psh, masticet bituminoze, "cut-backs")
2804	Hidrogjen, gaze të rralla dhe elemente të tjera jo metalike:

2804 21 00	--Argon
2804 30 00	- Azot
2811	Acide të tjera inorganike dhe përberjet të tjera inorganike të oksigjenit të jometaleve:
2811 21 00	Dioksid karboni
3214	Stuko xhami, stuko transplatuese, çimento resini, përberjet stukuese dhe mastice të tjera; mbushjet që përdoren në piktura; preparatet jo refraktare si përfaqësore për fasada, mure të brendshme, dysheme, tavane të brendshme apo të ngjashmet e tyre :
3214 90 00	- Të tjera
3824	Lidhësit e përgatitur për format apo kallëpet apo zemrat në fonderi; produktet kimike dhe preparatet kimike të industrive kimike apo të lidhjeve (përfshirë ato që konsistojnë në përzierje të produkteve natyrale), të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër :
3824 50 10	- -Beton gati për tu derdhur
3824 50 90	-- Të tjera
3921	Pllaka, fleta, filma, krisafe dhe shirita të tjera, prej plastike
3921 11 00	- Celulare: -- Prej polimerëve te stirenit
4401	Druri si lëndë djegëse, në kercunj, në kopace, në degë, në shkarpa apo në forma të ngjashme; druri në ashkla apo në copa; tallash dhe mbetje dhe kthime të drurit, nëse janë apo jo të aglomeruar në kercunj, briketa, sfera apo në forma të ngjashme:
4401 11 00 4401 12 00	Druri si lëndë djegëse, në kercunj, në kopace, në degë, në shkarpa apo në forma të ngjashme
4401 21 00 4401 22 00	- Druri në ashkla apo në copa:
4902	Gazetat, revistat dhe periodikët, nëse janë apo jo të ilustruara apo që përmbajnë materiale reklamuese :
4902 10 00	- Që del të paktën katër herë në javë
6904	Tullat ndërtuese qeramike, blloqet e dyshemeve, pllaka mbështetëse apo mbushëse dhe të ngjashmet e tyre:
6904 10 00	- Tulla ndërtuese
7208	Produkte të petëzuara të sheshta, prej hekuri ose çeliku të palidhura, në një gjatësi të barabartë apo më shumë se 600 mm, të petëzuara në të nxehtë, të papllakëzuara apo të riveshura:

Aneksi III

7208 37 00	-- Me trashësi 4.75 mm ose më shumë por që nuk e kalon 10 mm
7213	Shufra dhe shkopiinj, të petëzuara në të nxehtë, në spirale të përdredhura në mënyrë të çrregullt, prej gize dhe çeliku jo të lidhur
7213 91 10	--- Të një lloji të përdorur për perforcimin e betonit
7213 91 41	---- Që përmbajnë ndaj peshës 0,06 % apo me pak karbon
7213 91 49	---- Që përmbajnë ndaj peshës më shumë se 0,06 % por më pak se 0,25 % karbon
7214	Shufra dhe shkopiinj të tjere prej gize dhe çeliku jo të lidhur, jo me tej të punuara sesa të farketuara, petëzuara në të nxehtë, të terhequr në të nxehtë apo të stampuara në të nxehtë, por përfshirë ato të përdredhurat pasi janë petëzuar
7214 20 00	-Shufra që përmbajnë dhëmbëzime, brazda, flanxha apo deformime të tjera të prodhuara gjatë procesit të petëzimit apo të përdredhura pas petëzimit
7314	Veshje (përfshirë shiritat pafund), grilla, rrjeta dhe gardhe, prej telave të gizës apo çelikut; metal i zgjerueshëm prej gize apo çeliku:
7314 20 10	-- Prej teli të valëzuar